



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES
AGJENCIA KOMBËTARE E MBROJTJES CIVILE



RAPORT MONITORIMI / ZBATIMI I PLANIT TË INTEGRITETIT

AGJENCIA KOMBËTARE E MBROJTJES CIVILE

(JANAR – DHJETOR 2024)

Miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile

Nr. 1342/2, datë 09.08.2024

Tabela e Përmbajtjes

Shkurtime dhe akronime	3
Përmbledhje Ekzekutive	4
Qasja vlerësuese.....	5
Metodologjia e vlerësimit	5
Mbledhja dhe analiza e të dhënave	5
1. GJETJET E RAPORTIT	6
2. Ecuria e zbatimit të objektivave të tjera me afat 2024-2026	16
3. Konkluzione dhe Rekomandime.....	18
4. Hapa të tjera	18

Shkurtime dhe akronime

MM	Ministria e Mbrojtjes
AKMC	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile
NATO	North Atlantic Treaty Organization
CIDS	Qendra për Integritet në Sektorin e Mbrojtjes, Norvegji
DZRFP	Drejtoria e Zvogëlimit të Riskut dhe Fatkeqësive dhe e Parandalimit
DGKPE	Drejtoria e Gatishmërisë dhe Koordinimit të Përgjigjes Emergjente
DRRKF	Drejtoria e Rehabilitimit, Rimëkëmbjes dhe Kompensimit nga Fatkeqësitë
DBNP	Drejtoria e Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Projekteve
DETTI	Drejtoria e Edukimit, Trajnimit dhe Teknologjisë së Informacionit
DFSHM	Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse
SSHKMP	Sektori i Shtypit, Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun
PSV	Procedura Standarde Veprimi
PI	Plan Integriteti
DAP	Departamenti i Administratës Publike

Përmbledhje Ekzekutive

Lufta kundër korrupsionit është prioritet i qeverisë shqiptare. Në vitin 2024, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile në zbatim të pikës 5, të Urdhrit të Ministrit të Mbrojtjes Nr. 516, datë 19.04.2022 për miratimin e “*Planit të Integritetit të Ministrisë së Mbrojtjes 2022-2025*”, në përmbushje të masës A.8.4 dhe A.9.3 të Planit të Veprimit 2020-2023, të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, të miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 247, datë 20.03.2015, të ndryshuar, si dhe duke u bazuar në Metodologjinë e Vlerësimit të Riskut të Integritetit në Institucionet e Qeverisjes Qendrore, të miratuar me urdhrin e Ministrit të Drejtësisë Nr. 334, datë 07.10.2020, hartoi Planin e Integritetit të institucionit për vitet 2024-2026.

Ky dokument, i miratuar me urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile Nr.37, datë 02.02.2024, përfaqëson përpjekjen institucionale për të vendosur një sistem efektiv të menaxhimit të integritetit për periudhën kohore 2024-2026 dhe shërben si instrument efektiv për luftën kundër korrupsionit në nivelin e institucionit me qëllim përmirësimin e politikave, rregullave, praktikave të parandalimit të korrupsionit, si dhe forcimin e rezistencës institucionale ndaj shkeljeve të integritetit.

Në Planin e Integritetit të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile janë të parashikuara gjithsej 28 masa të karakterit rregullator dhe operacional, të shpërndara në 6 objektiva, të cilat konsistojnë kryesisht në përmbushjen e detyrimeve të; transparencës, menaxhimit financiar, menaxhimit të burimeve njerëzore, etikës, efektivitetit në përmbushjen e detyrave dhe të ushtrimit të funksioneve administrative, për të cilat janë parashikuar aktivitete përkundrejt çdo risku të evidentuar.

Plani i Integritetit të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, siguron përfshirjen e konceptit të integritetit në aspektet kryesore të punës së AKMC dhe strukturave të saj.

Sa më sipër, objektivat strategjike të Planit të Integritetit të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile për periudhën 2024-2026, janë:

1. Rritja e transparencës së Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe informimit të publikut;
2. Menaxhimi efektiv i riskut të integritetit me fokus në fushat e përgjegjësisë së Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile;
3. Përmirësimi i menaxhimit të burimeve njerëzore në të gjitha nivelet dhe funksionet në agjenci;
4. Forcimi i mekanizmave të kontrollit të brendshëm;
5. Përmirësimi i menaxhimit financiar dhe prokurimeve publike;
6. Përmirësimi i procedurave në fushën e inspektimeve;

Njësitë përgjegjëse për zbatimin e tyre, janë të gjitha strukturat në Drejtoritë e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile. Afati i zbatimit të këtij Plani Integriteti është deri në vitin 2026. Raporti i Monitorimit të zbatimit të Planit të Integritetit të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile për vitin 2024, është i pari dokument i hartuar që prej miratimit të Planit të Integritetit.


Në përputhje me Metodologjinë e Monitorimit të Planit të Integritetit për institucionet e qeverisjes qendrore, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile ka hartuar këtë raport monitorimi duke analizuar dhe vlerësuar progresin e arritur.

Raporti jep të dhëna për të gjitha objektivat dhe masat institucionale të parashikuara në Planin e Integritetit të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile në përgjithësi, duke u fokusuar në arritjet për vitin 2024, për statusin e zbatimit të tyre, informacion mbi problematikat e hasura në zbatimin e tyre, të dhëna për veprimtarinë operacionale të njësive organizative kontribuese, etj.

Për vitin 2024, Plani i Integritetit ka të parashikuar për zbatim gjithsej 18 masa/aktivitete, nga të cilat 12 i përkasin 6 mujorit të dytë të vitit 2024, dhe janë të shpërndara në pesë objektiva.

Nga monitorimi rezulton se në totalin prej 12 masash të parashikuara për zbatim për periudhën Korrik – Dhjetor 2024; janë përmbyshur 12 masat dhe nuk rezulton asnjë masë e pazbatuar.

Për vitin 2024, Plani i Integritetit në total i parashikuar për zbatim është realizuar 100%, në të gjitha masat dhe aktivitetet (18 masa/aktivitete).



Qasja vlerësuese

Raporti vjetor i monitorimit/zbatimit të Planit të Integritetit të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile për periudhën Janar - Dhjetor 2024, përmban një analizë të përgjithshme të performancës institucionale për t'i rezistuar shkeljeve të integritetit si dhe çështje të transparencës institucionale në luftën kundër korrupsionit.

Metodologjia e vlerësimit

Ky raport është hartuar në bazë të kontributit të drejtorive dhe strukturave të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, të një grupi të brendshëm pune dhe të koordinatorit të Integritetit. Raporti përmban një analizë sintezë cilësore dhe sasiore të kontributit të tyre. Analiza cilësore e këtij raporti bazohet në vlerësimin institucional të kuadrit organizativ, funksional dhe operacional të tyre. Analiza sasiore e këtij raporti vjetor bazohet në vlerësimin e të dhënave statistikore të strukturave/njësive kontribuese.

Mbledhja dhe analiza e të dhënave

Të dhënat e këtij raporti janë grumbulluar nga struktura e posaçme përgjegjëse për mbledhjen, analizën e informacionit, si edhe për hartimin e raportit të monitorimit. Struktura i raporton titullarit të institucionit mbi

ecurinë e zbatimit të Planit të Integritetit. Titullari i institucionit merr masa për garantimin e zbatimit të Planit të Integritetit dhe adresimin e problematikave të evidentuara. Këto të dhëna janë raportuar nga përfaqësuesit e njësive kontribuese në këtë raport, të cilat janë: Drejtoria e Zvogëlimit të Riskut dhe Fatkeqësive dhe e Parandalimit, Drejtoria e Edukimit, Trajnimit dhe Teknologjisë së Informacionit, Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, Sektori i Shtypit, Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun, Sektori i Inspektimit, Sektori i Auditimit.

Mbledhja e informacionit nga këto njësi është kryer nëpërmjet plotësimit të aneksit të këtij raporti. Secila njësi ka raportuar mbi; hapat e ndërmarrë dhe statusin e realizimit të tyre për çdo masë të parashikuar për zbatim për periudhën Janar - Dhjetor 2024; akte dhe dokumente të hartuara; rekomandime dhe konkluzione. Draft-raporti është konsultuar me njësitë përgjegjëse për zbatim dhe raportim. Përpara publikimit, draft-raporti është miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile.


1. GJETJET E RAPORTIT

Objektivi 1: Fusha e transparencës dhe informimit të publikut, përmirësim i procesit të informimit të publikut nëpërmjet forcimit të kapaciteteve dhe rritjes së transparencës, llogaridhënies dhe informimit të publikut.

Përmes këtij objektivi synohet përditësimi i faqes zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile me raporte të auditit; zbatimit të buxhetit; informacion mbi procedurat e prokurimit, ngritjen e njësisë përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesit në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, publikimin e informacionit për procedurat që duhet ndjekur për të bërë një kërkesë informimi.

Ky objektivi përmban një numër total prej 4 masash, 3 prej të cilave specifike të planifikuara për t’u zbatuar nga njësitë e përfshira për vitin 2024, nëpërmjet 7 aktiviteteve, si dhe një masë e shtrirë në afat kohor 2024-2025. Njësitë raportuese për këtë objektivi janë strukturat e DFSHM; DRRKF; Drejtoritë e AKMC; Sektori i Auditit; SSHKMP; SBNJ. Gjatë periudhës raportuese janë realizuar masat (produktet) dhe janë kryer aktivitetet sipas tabelës mëposhtë, që rezultojnë nga monitorimi:

Objektivi 1	Masat dhe Aktivitetet	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa të parashikuara dhe plotësisht të realizuara për Janar-Dhjetor 2024	Masa të parealizuara për Janar-Dhjetor 2024	Aktivitete të parashikuara dhe plotësisht të realizuara për Janar-Dhjetor 2024	Aktivitete të parealizuara për Janar-Dhjetor 2024
Përmirësim i procesit të informimit të publikut nëpërmjet forcimit të kapaciteteve dhe rritjes së transparencës, llogaridhënies dhe informimit të publikut.	Masa/ Aktivitete	3	0	7	0



Masa 1.1, e përditësimit të faqes zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile me raporte të auditit; zbatimit të buxhetit; informacion mbi procedurat e prokurimit, gjatë monitorimit Janar-Dhjetor 2024 është realizuar 100%, me publikimin në muajin Prill 2024 të raportit vjetor të auditimit, në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile. Ky raport përmban të gjitha të dhënat e nevojshme sipas ligjit të mbrojtjes së të dhënave personale dhe përfshin informacion mbi procedurat e prokurimit dhe zbatimin e buxhetit. Me këtë hap, ne kemi përmirësuar ndjeshëm transparencën dhe llogaridhënien brenda institucionit tonë. Të gjitha këto të dhëna janë të aksesueshme për publikun, duke rritur besimin e qytetarëve në institucionin tonë.

Masa 1.2, e krijimit të një sistemi për shpërndarjen e informacionit (në rastet e emergjencave, si bazë për informimin sipas kanaleve zyrtare), me afat zbatimi 2024-2025, gjatë monitorimit Janar-Dhjetor 2024, është realizuar me zhvillimin e disa takimeve, seminareve dhe draftimin e disa ideve.

Masa 1.3, e cila ka si objektiv ngritjen e njësisë përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesit është realizuar plotësisht. Në Ministrinë e Mbrojtjes, është ngritur autoriteti përgjegjës për parandalimin, kontrollin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesave, i cili mban kontakte në vijimsi me ILDKPI për deklarimin e pasurive dhe të konfliktit të interesave. Kjo strukturë e ngritur në MM koordinon rast pas rasti me njësinë e SBNJ në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, për deklarimet e parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore, për punonjësit e strukturës së saj.


Masa 1.4, e publikimit të informacionit për procedurat që duhet ndjekur për të bërë një kërkesë informimi, për qytetarët, përfitues të kompensimeve, për vitet për të cilat është përgjegjëse Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, gjatë monitorimit Janar-Dhjetor 2024, është realizuar 100%. Në përputhje me Ligjin Nr.119/2014, “Për të drejtën për informim”, Sektori i Shtypit, Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun, ka krijuar dhe publikuar një procedurë standarde për të bërë një kërkesë për informim. Kjo procedurë është e shoqëruar me një model kërkesë për informacion të miratuar, i cili është bërë i disponueshëm për qytetarët në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile. Informacioni përfshin hapat e detajuar që qytetarët dhe përfituesit e kompensimeve duhet të ndjekin për të bërë një kërkesë informimi. Kjo nismë ka përmirësuar ndjeshëm aksesin e qytetarëve në informacion dhe ka rritur transparencën e procesit, duke garantuar që të gjithë qytetarët të kenë mundësinë të marrin informacionin e nevojshëm në mënyrë të qartë dhe të shpejtë.

Objektivi 2. Fusha e menaxhimit të burimeve njerëzore: Përmirësim i procesit të menaxhimit të burimeve njerëzore nëpërmjet forcimit të kapaciteteve dhe rritjes së transparencës dhe llogaridhënies.

Përmes këtij objektivi synohet; hartimi dhe miratimi i procedurave standarde të veprimit (PSV) për secilin proces pune në agjenci, si dhe hartimi i planit vjetor për trajnime për personelin e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile. Ky objektiv përmban në total 4 masa për vitin 2024 nëpërmjet 7 aktiviteteve, dy prej të cilave specifike të

planifikuara për t'u zbatuar nga njësitë e përfshira për periudhën Korrik – Dhjetor 2024, nëpërmjet 2 aktiviteteve. Janë kryer të gjitha masat dhe aktivitetet për vitin 2024, duke mundur realisht 100% të këtij objekti. Njësitë raportuese për këtë objekt janë Drejtoritë e AKMC; SBNJ; Zyrtarët Raportues të të gjithë strukturave të AKMC. Gjatë periudhës raportuese janë realizuar masat (produktet) dhe janë kryer aktivitetet sipas tabelës mëposhtë, që rezultojnë nga monitorimi:

Objekti 2	Masat dhe Aktivitetet	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa të parashikuara dhe plotësisht të realizuara për Janar-Dhjetor 2024	Masa të përealizuara për Janar-Dhjetor 2024	Aktivitetet të parashikuara dhe plotësisht të realizuara për Janar-Dhjetor 2024	Aktivitetet të përealizuara për Janar-Dhjetor 2024
Përmirësim i procesit të menaxhimit të burimeve njerëzore nëpërmjet forcimit të kapaciteteve dhe rritjes së transparencës dhe llogaridhënies.	Masa/ Aktivitete	4		7	0



Masa 2.1, që ka lidhje me hartimin dhe miratimin e Procedurave Standarde të Veprimit (PSV) për secilin proces pune në agjenci, është realizuar 100% me hartimin e procedurave standarde të të gjithë strukturave të AKMC, për 6 Drejtoritë dhe 20 Sektorët e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile. Procedurat Standarde të Veprimit, janë miratuar nga titullari institucionit si dhe janë informuar të gjithë punonjësit e AKMC.

Me këtë hap, ne kemi rritur nivelin e cilësisë së punës së strukturave, nëpërmjet manualeve të proceseve të punës për çdo njësi të institucionit, dhe dokumenteve që rregullojnë në detaje proceset e punës të realizuara nga çdo strukturë/funksion i institucionit.

Masa 2.2, lidhet me përfshirjen e trajnimit për antikorrupsionin dhe integritetin, në planin vjetor të trajnimeve për vitin 2024. Në bashkëpunim /koordinim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike, në bazë të nevojave të institucionit janë ndjekur nga punonjësit e AKMC, disa kurrikula, të tilla si: “Kursi i KE hyrje në parandalimin e korrupsionit”, “Etika, integriteti dhe trasparenca”, “Etika në Administratën Publike”. Punonjësit janë njohur gjithashtu dhe me Urdhrin Nr.70, datë 21.01.2025 “Manual praktik mbi etikën në administratën publike”, etj. Me këtë hap ne kemi përmirësuar procesin e menaxhimit të burimeve njerëzore nëpërmjet forcimit të kapaciteteve dhe rritjes së transparencës dhe llogaridhënies.

Masa 2.3, që lidhet me hartimin e planit vjetor për trajnime e mundësi për zhvillim profesional, është realizuar me evidentimin e nevojave për trajnim dhe zhvillim të personelit nga të gjithë zyrtarët raportues në seksionin e posaçëm të formularit të vlerësimit të performancës në punë për 6 mujorin e parë & të dytë të vitit 2024. Me vlerësimin e nevojave për trajnim sipas fushave të ushtrimit të detyrave në të gjitha strukturat e agjencisë, është hartuar plani i nevojave për trajnim për personelin e AKMC 2025, i cili është miratuar nga Titullari i Institucionit dhe është përcjellë në MM dhe ASPA.

Masa 2.4, që lidhet me angazhimin për zhvillimin e trajnimit dhe përfshirjen e tematikave në planin vjetor të trajnimeve, që lidhen me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, për të drejtën e informimit, si dhe ligjin për konfliktin e interesit; nga punonjësit e AKMC janë ndjekur disa kurrikula, të lidhura me këto tematika. Trajnime në këto fusha janë përfshirë dhe në planin e nevojave për trajnim për personelin e AKMC 2025, i cili është miratuar nga Titullari i Institucionit dhe është përcjellë në MM dhe ASPA.

Objektivi 3. Menaxhimi financiar dhe prokurimet publike, transparencë proaktive e përmirësuar për të gjithë fazat e procesit të prokurimit publik.

Përmes këtij objektivi synohet; përditësimi i programit të transparencës, planifikim adekuat i procedurave të prokurimit si dhe planifikim i nevojave të çdo drejtorie referuar objektivave. Ky objektivi përmban 5 masa në total, një masë specifike të planifikuar për t’u zbatuar nga njësitë e përfshira për 6 mujorin e parë 2024, një masë të planifikuar për t’u zbatuar për periudhën kohore 2024-2025, si dhe 3 masa të tjera për vitin 2024 nëpërmjet 6 aktiviteteve. Njësitë raportuese për këtë objektivi janë Sektori i Prokurimit dhe Marrëdhënieve Kontraktuale; SSHKMP, Drejtoritë e AKMC. Gjatë periudhës raportuese janë realizuar masat (produktet) dhe janë kryer aktivitetet sipas tabelës mëposhtë, që rezultojnë nga monitorimi:

Objektivi 3	Masat dhe Aktivitetet	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa të parashikuara dhe plotësisht të realizuara për Janar-Dhjetor 2024	Masa të përcaktuara për Janar-Dhjetor 2024	Aktivitetet të parashikuara dhe plotësisht të realizuara për Janar-Dhjetor 2024	Aktivitetet të përcaktuara për Janar-Dhjetor 2024
Përditësimi i programit të transparencës.	Masa/ Aktivitete	4	0	7	0

Masa 3.1 që lidhet me publikimin në programin e transparencës të rregjistrit të parashikimeve dhe rregjistrit të realizimeve të prokurimeve publike, është realizuar 100% me publikimin në programin e transparencës të rregjistrit të parashikimeve dhe realizimeve të prokurimit publik për vitin 2024, në bashkëpunim me Sektorin e Shtypit, Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile. Me këtë hap, ne kemi përmirësuar ndjeshëm transparencën dhe llogaridhënien brenda institucionit tonë. Të gjitha këto të dhëna janë të aksesueshme për publikun, duke rritur besimin e qytetarëve në institucionin tonë.

Masa 3.2 që lidhet me publikimin e kontratave të lidhura nga Agjencia, me afat kohor 2024-2026, është realizuar 100% për vitin 2024, me publikimin e kontratave të lidhura nga Sektori i Prokurimeve dhe Marrëdhënieve Kontraktuale në DFSHM, në AKMC, të cilat janë dërguar për publikim pranë APP-së si institucioni përgjegjës, si dhe janë publikuar në Programin e Transparencës në bashkëpunim me Sektorin e Shtypit, Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun.

Masa 3.3 që lidhet me mirë planifikimin e procedurave në rregjistrin e parashikimit të prokurimeve publike, në mënyrë që të shmangen ndryshimet e shpeshta gjatë vitit, është realizuar në masën 100%, me hartimin e një plani adekuat të procedurave, kjo si pasojë e takimeve me të gjitha drejtoritë për njohjen me procedurën, ndëgjegjësimin e tyre për dërgimin në kohë të nevojave sipas fushës së tyre të përgjegjësisë, etj. Me arritjen e këtij objekti nuk ka patur ndryshime të rregjistrit të parashikimeve të prokurimeve publike për vitin 2024.


(DZRFP), ka marrë pjesë në takime të brendshme të zhvilluara përgjatë vitit 2024 me drejtoritë dhe sektorët e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, me qëllim përmirësimin e proceseve të prokurimeve publike dhe kryerjen e proceseve të tjera të punës, në mënyrë sa më eficiente. DZRFP ka anëtarë të stafit në grupe pune për procedura prokurimi, të caktuar me urdhra të brendshëm, sipas rastit.

Masa 3.4 që lidhet me mungesën e një mirëorganizimi dhe funksionalizimi të punës në kohë mes drejtorive të AKMC, nga DFSHM dhe SPMP janë realizuar disa takime ndërgjegjësuëse dhe informuese me Drejtorët e Drejtorive të AKMC, me synim mirëorganizimin dhe funksionalizimin e punës për realizimin e të gjitha objektivave dhe realizimin në kohë të detyrave, etj. Ky objektivi është realizuar në masën 100% me respektimin e kalendarit të planifikimit të detyrave.

(DZRFP), ka marrë pjesë në takime të brendshme të zhvilluara përgjatë vitit 2024 me drejtoritë dhe sektorët e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, me qëllim përmirësimin e proceseve të prokurimeve publike dhe kryerjen e proceseve të tjera të punës, në mënyrë sa më eficiente.

Masa 3.5 lidhet me planifikimin e nevojave dhe shërbimeve sipas fushës së përgjegjësisë së çdo drejtorie, për t'u përfshirë në regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike pas miratimit të buxhetit të vitit pasardhës, gjatë periudhës së monitorimit është realizuar plotësisht me dërgimin pranë DFSHM nga çdo drejtori brenda afateve të caktuara të të gjitha nevojave dhe kërkesave të tyre për shërbime.

(DZRFP) ka marrë pjesë në takime të brendshme të zhvilluara përgjatë vitit 2024 me drejtoritë dhe sektorët e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, me qëllim përmirësimin e proceseve të prokurimeve publike dhe kryerjen e proceseve të tjera të punës, në mënyrë sa më eficiente.



Objektivi 4. Fusha e inspektimeve, përmirësim i procesit të inspektimit nëpërmjet forcimit të kapaciteteve dhe procedurave transparente.

Objektivi 4	Masat dhe Aktivitetet	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa të parashikuara dhe plotësisht të realizuara për Janar-Dhjetor 2024	Masa të parealizuara për Janar-Dhjetor 2024	Aktivitete të parashikuara dhe plotësisht të realizuara për Janar-Dhjetor 2024	Aktivitete të parealizuara për Janar - Dhjetor 2024
Përfshirja e trajnimeve të inspektorëve dhe strukturave përgjegjëse mbi procedurat e inspektimit.	Masa/ Aktivitete	3	0	3	0

Përmes këtij objektivi synohet; përfshirja e trajnimeve të inspektorëve dhe strukturave përgjegjëse mbi procedurat e inspektimit, organizimi dhe pjesëmarrja në trajnime specifike në lidhje me procedurat e inspektimit. Ky objektivi përmban tre masa në total, një masë specifike të planifikuar për t'u zbatuar nga njësitë e përfshira për 6 mujorin e parë të vitit 2024 dhe dy masa të tjera brenda vitit 2024. Njësitë raportuese për këtë objektivi janë Sektori i Inspektimit.

Masa 4.1 Sektori i Inspektimit në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile ka për mision inspektimin e institucioneve dhe strukturave shtetërore dhe subjekteve private, për zbatimin e dispozitave ligjore e nënligjore në fushën e mbrojtjes civile. Sektori i Inspektimit ka përcaktuar aktivitetet vjetore të cilat do të ndikojnë në përmirësimin e procesit të inspektimit nëpërmjet forcimit të kapaciteteve dhe procedurave transparente.


Sektori i Inspektimit përveç rolit dhe funksionit inspektues gjatë inspektimeve informon dhe përcjell çdo informacion ligjor mbi procedurat ligjore inspektuese. Subjekteve u jepet informacion i plotë mbi procedurat e inspektimit. Vetë Sektori i Inspektimit është pjesë e trajnimeve nga struktura përgjegjëse e inspektimit.

Gjatë periudhës raportuese janë realizuar disa trajnime në fushën e inspektimit dhe janë kryer disa aktivitete informuese, që rezultojnë nga monitorimi i periudhës raportuese. Priten ndryshime në ligjin e inspektimeve të cilat do të shoqërohen më tej me trajnime, fushata informuese, etj.

Ligji për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë është në proces ndryshimi dhe përfaqësues nga AKMC kanë marrë pjesë në cilësinë e anëtarëve të grupit të punës, duke kontribuar për ndryshimet e nevojshme në ligj. Ndryshimet e pritshme ligjore prekin edhe procedurat e inspektimit të AKMC-së.

Masa 4.2 Sektori i Inspektimit në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile ka për mision inspektimin e institucioneve dhe strukturave shtetërore dhe subjekteve private, për zbatimin e dispozitave ligjore e nënligjore në fushën e mbrojtjes civile. Sektori i Inspektimit ka përcaktuar aktivitete vjetore të cilat do të ndikojnë në përmirësimin e procesit të inspektimit nëpërmjet forcimit të kapaciteteve dhe procedurave transparente. Në lidhje me përmirësimin e sistemit të raportimit duke krijuar metoda efikente për mënyrën e raportimit, Sektori i Inspektimit gjatë komunikimit të përhershëm me Inspektoratin Qendror, por edhe me institucione të tjera shtetërore, krijoi një poces standart raportimi e munduruar kjo nga sistemi elektronik "e-inspektimi".

Masa 4.3 Sektori i Inspektimit ka përcaktuar aktivitete vjetore të cilat do të ndikojnë në përmirësimin e procesit të inspektimit nëpërmjet forcimit të kapaciteteve dhe procedurave transparente. Për realizimin e programit vjetor të inspektimit 2024, Sektori i Inspektimit, realizoi plane mujore, plane ku u përfshinë kryesisht prefektura dhe bashki, ku u kryen inspektime dhe u verifikua zbatimi i detyrimeve ligjore, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë.




Objektivi 5. Auditimi i brendshëm dhe kontrolli, forcimi i rolit të Sektorit të Auditimit të brendshëm, kryerja e auditimeve përkatëse me synim forcimin e integritetit të stafit të AKMC-së”.

Objektivi 5	Masat dhe Aktivitetet	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa të parashikuara dhe plotësisht të realizuara për Janar-Dhjetor 2024	Masa të parealizuara për Janar-Dhjetor 2024	Aktivitete të parashikuara dhe plotësisht të realizuara për Janar-Dhjetor 2024	Aktivitete të parealizuara për Janar - Dhjetor 2024
Vlerësimi i performancës dhe efektivitetit të sistemeve e të kontrolleve si dhe rekomandimet dhe ndjekja e tyre.	Masa/ Aktivitete	2	0	2	0

Përmes këtij objektivi synohet; përmirësimi i proceseve të punës nëpërmjet forcimit të kapaciteteve me synim forcimin e integritetit të stafit të AKMC-së. Ky objektiv përmban dy masa në total për vitin 2024. Njësitë raportuese për këtë objektiv janë Sektori i Auditimit.

Masa 5.1 që lidhet me vlerësimin të performancës dhe rritjen e efektivitetit të sistemeve e të kontrolleve. nëpërmjet kryerjes së trajnimeve në fushën e auditimit është realizuar për vitin 2024; stafi i njësisë së auditimit ka ndjekur trajnimin e vijueshëm për audituesin e brendshëm organizuar nga Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave si dhe trajnime të ofruara nga ASPA lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

Masa 5.2 që lidhet me rekomandimet për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm të AKMC-së, nëpërmejt nxjerrjes së rekomandimeve pas zhvillimit të kontrolleve dhe ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna, është realizuar plotësisht për vitin 2024, me auditimet e kryera gjatë këtij viti, bazuar në planin vjetor të auditimeve, në të cilat nga audituesit janë dhënë rekomandimet përkatëse për përmirësimin e veprimtarisë së kontrollit të brendshëm. Statusi i zbatimit të rekomandimeve është pjesë e planit vjetor të auditimit.



Objektivi 6. Menaxhimi efektiv i riskut të integritetit me fokus në fushat e përgjegjësisë së AKMC-së, i cili ka për qëllim përmirësimin e proceseve të punës nëpërmjet forcimit të kapaciteteve, me synim forcimin e integritetit të stafit të AKMC-së.

Objektivi 6	Masat dhe Aktivitetet	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa të parashikuara dhe plotësisht të realizuara për Janar-Dhjetor 2024	Masa të parealizuara për Janar-Dhjetor 2024	Aktivitete të parashikuara dhe plotësisht të realizuara për Janar-Dhjetor 2024	Aktivitete të parealizuara për Janar - Dhjetor 2024
Trajnime të strukturave të mbrojtjes civile dhe vullnetarëve, një sistem për mbledhjen dhe mbrojtjen e të dhënave të humbjeve nga	Masa/ Aktivitete	3	0	3	0

fatkeqësitë, një metodikë eficiente e shpërndarjes së informacionit.					
--	--	--	--	--	--

Përmes këtij objektivi synohet; forcimi i integritetit të stafit të AKMC-së, përmes menaxhimit efektiv të riskut të integritetit dhe përmirësimit të proceseve të punës nëpërmjet forcimit të kapaciteteve me synim forcimin e integritetit të stafit të AKMC-së. Ky objektivi përmban 11 masa në total, tre masa specifike të planifikuara për t'u zbatuar nga njësitë e përfshira për vitin 2024, dhe 8 masa të tjera brenda periudhës kohore 2025-2026. Njësitë raportuese për këtë objektivi janë; Sektori i Prokurimit dhe Marrëdhënieve Kontraktuale; SSHKMP, Drejtoritë e AKMC; DBNP; DGKPE; DETTI; DZRFP; DFSHM.

Masa 6.5 lidhet me zhvillimin e trajnimeve periodike për strukturat e mbrojtjes civile dhe vullnetarëve. Gjatë vitit 2024, Drejtoria e Edukimit, Trajnimit dhe Teknologjisë së Informacionit DETTI, me qëllim zbatimin dhe zhvillimin e programit të trajnimit për mbrojtjen civile, ka ndërmarrë dhe realizuar një sërë procesesh administrative dhe aktiviteteve, si më poshtë:

- Hartimi i planit të trajnimeve dhe stërvitjeve të mbrojtjes civile për vitin 2024;
- Hartimi i një kalendari vjetor trajnimesh;
- Bashkëpunimi dhe bashkërendimi i punës me UNDP, bazuar marrëveshjes së Financimit ndërmjet Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim dhe Ministrisë së Mbrojtjes e përfaqësuar nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, për realizimin e modulit të trajnimit bazë të mbrojtjes civile për strukturat e mbrojtjes civile në nivel qarku dhe bashkie;
- Zhvillimi i trajnimeve bazuar marrëveshjes me UNDP.

Në total, personeli i trajnuar në nivel vendor është 207 persona.

- Vazhdimi i procesit për trajnimet e fazës së dytë *“Moduli i përdorimit të bazës së të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë”*, bazuar programit të trajnimit.

✓ DETTI në zbatim të Programit të Trajnimit për Mbrojtjen Civile për strukturat shtetërore, subjektet private dhe vullnetarët dhe planit të punës të DETTI-it për vitin 2024, pas realizimit të veprimtarive trajnuese me UNDP-në, vijoi me përgatitjet për realizimin e trajnimit për modulën 10 *“Përdorimi i bazës së të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë”*, i cili do të realizohej në 6-mujorin e dytë të vitit 2024.

- Zbatimi i planit të stërvitjeve për vitin 2024 bazuar marrëveshjes së Financimit ndërmjet Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim dhe Ministrisë së Mbrojtjes e përfaqësuar nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile;
- Nëpërmjet bashkëpunimit me UNDP, nga DETTI u realizuan 2 stërvitje, një gjatë periudhës Maj-Qershor dhe tjetra gjatë periudhës Shtator-Tetor, *“Pishë Poro 2024”* – Fier, *“Përgatitje Dimërore 2024”* - Dibër dhe Kukës.

Në total pjesëmarrës në stërvitje ishin 91 persona, në role të ndryshme.

Në kuadër të projektit *“Flood North ALB”*, gjatë muajit Nëntor 2024, u zhvillua TTX i këtij projekti, 55 persona pjesëmarrës.

✓ DZRFP ka përgatitur materialet trajnuese për zhvillimin e modulit Nr.1-Fatkeqësitë që prekin territorin e Republikës së Shqipërisë dhe Vlerësimi i Riskut dhe modulit Nr. 3 - Planifikimi i menaxhimit të emergjencave civile, me qëllim zbatimin e programit *“Moduli i trajnimit bazë të Mbrojtjes Civile për Strukturat e Mbrojtjes Civile në nivel qarku dhe bashkie”*.

Në fokus këto module kishin: (a) aftësimin dhe krijimin e kompetencës profesionale të personelit të sistemit të mbrojtjes civile për zbatimin e metodologjisë së vlerësimit të riskut dhe hartimin e dokumentit të Strategjisë për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë në nivel lokal/sectorial, si dhe (b) njohjen me kapacitetet në fushën e mbrojtjes civile dhe rolin që luan planifikimi i fazave të emergjencës në rritjen e efikasitetit të sistemit të mbrojtjes civile.

✓ DZRFP u angazhua në trupën e trajnerëve, me përfaqësim sipas Urdhrit Nr. 41, datë 07.02.2024 të Drejtorit të Përgjithshëm të AKMC “Për miratimin e trupës së trajnerëve të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile për vitin 2024” dhe u zhvilluan takime sipas kalendarit përgjatë vitit 2024. Statusi aktual: realizuar.


✓ DZRFP - Fuqizimi i menaxhimit të Riskut nga Fatkeqësitë në nivel lokal – LOCAL DRM.

Projekti “Strengthening Disaster Risk Management Capability at Local Level – LOCAL DRM”- “Fuqizimi i menaxhimit të Riskut nga Fatkeqësitë në nivel lokal”, financuar nga Komisioni Europian, do të implementohet bazuar në Marrëveshjen e Grantit 101142625 — LOCAL DRM — UCPM-2023-TRACK1-IBA, lidhur ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, njëra palë, dhe Komisioni Evropian-DG ECHO, me një kohëzgjatje 18 muaj (Janar 2024- Qershor 2025). Objektivi kryesor i kësaj iniciative është - “Mbështetja e strukturave të mbrojtjes civile në nivel qarku dhe bashkie për të përmirësuar dhe forcuar kapacitetet e tyre në drejtim të parashikimit të rreziqeve, vlerësimit të riskut, parandalimit dhe planifikimit”. Në funksion të implementimit të paketave të këtij projekti, sipas termave të Grantit, janë nënshkruar kontratat përkatëse të punës. Me vlerësimin e kapaciteteve dhe nevojave për trajnim, do të ngrihet programi për organizimin e seminareve dhe seancave të trajnimit për stafin e strukturave të nivelit vendor mbi vlerësimin dhe menaxhimin e riskut nga fatkeqësitë. Ky projekt mbështetet teknikisht nga stafi i DZRFP.

Masa 6.8 lidhet me ngritjen e një sistemi për mbledhjen dhe mbrojtjen e të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë nëpërmjet konsultimeve të nevojshme për realizimin e tij. Pas konsultimeve me Drejtoritë e AKMC, AKSHIN dhe aktorë të tjerë të fushës së përgjegjësisë, në zbatim të VKM-së Nr. 345 datë 26.05.2022 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë”, është arritur të ndërtohet një sistem elektronik për mbledhjen e të dhënave nga humbjet nga fatkeqësitë. Në sistemin e krijuar bashkitë kanë detyrimin që të hedhin të dhënat parësore dhe më pas të vijohet me plotësimin e të dhënave të tjera sipas fushës së përgjegjësisë nga prefektura, ministritë ose institucione të tjera që kanë akses në sistem.

Për të mundur një funksionim sa më të shpejtë dhe korrekt të sistemit, pas krijimit të tij ai është përfshirë në databazat kombëtare brenda AKSHIT. Është vijuar me trajnimet e stafit të AKMC, përdoruesve të caktuar nga Bashkitë dhe Prefekturat, si dhe janë nisur kërkesat ministrive dhe disa institucioneve qendrore për përcaktimin e personave që do jenë përgjegjës për hedhjen e të dhënave nga ana e tyre.

Masa 6.11 lidhet me mungesën e një procesi formal për shpërndarjen e informacionit mes drejtorive në AKMC si dhe miratimin e metodikës eficientë të shpërndarjes së informacionit. Përmes takimeve të brendshme për përcaktimin e një procesi eficient, është mundur që informacioni të shpërndahet duke ndjekur hierarkinë, bazuar në procedurat standarde të veprimit (PSV), hartuar dhe miratuar në vitin 2024, për secilin proces pune në Agjenci.



2. Ecuria e zbatimit të objektivave të tjera me afat 2024-2026

➤ Drejtoria e Zvogëlimit të Riskut dhe Fatkeqësive dhe e Parandalimit (DZRFP) dhe Drejtoria e Edukimit, Trajnimit dhe Teknologjisë së Informacionit (DETTI), në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, japin të dhëna për realizimin e objektivave të tjera me afat 2024-2026, masat institucionale të parashikuara në Planin e Integritetit dhe statusin e zbatimit të tyre përgjatë vitit 2024, sa i takon fushave të tyre të përgjegjësisë.

Realizimi i misionit dhe objektivave të Agjencisë realizohet nga drejtoritë respektive, të cilat ushtrojnë detyrat sipas fushës së përgjegjësisë, referuar ligjit, akteve ligjore dhe nënligjore. Drejtoria e Zvogëlimit të Riskut dhe Fatkeqësive dhe e Parandalimit (DZRFP) ka për mision të garantojë bashkërendimin ndërinstitucional, për hartimin e programeve dhe të strategjive në fushën e mbrojtjes civile, vlerësimin e riskut nga fatkeqësitë dhe planet e emergjencave civile, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

➤ Drejtoria e Edukimit, Trajnimit dhe Teknologjisë së Informacionit (DETTI), ka për mision të garantojë trajnimin e vazhdueshëm të strukturave shtetërore, subjekteve private dhe vullnetarëve, edukimin dhe ndërgjegjësimin e publikut për rritjen e aftësive për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, si dhe zbatimin dhe miradministrimin e infrastrukturës së teknologjisë së informacionit, për arritjen e objektivave të Agjencisë. Për vitin 2024, këto dy struktura të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile (DZRFP & DETTI) raportojnë në lidhje me:

Objekti 6. Menaxhimi efektiv i riskut të integritetit me fokus në fushat e përgjegjësisë së AKMC-së, i cili ka për qëllim përmirësimin e proceseve të punës nëpërmjet forcimit të kapaciteteve, me synim forcimin e integritetit të stafit të AKMC-së.

2.	Mungesë e rrjetit kombëtar të vullnetarizmit.	Krijimi i një rrjeti kombëtar të vullnetarizmit.	DETTI; Drejtoritë e AKMC.	2024-2026	Takime për rritjen e ndërgjegjësimit; Hartimi i procedurave standarde; Trajnime dhe shpërndarje të praktikave.
----	---	--	------------------------------	-----------	--

Masa 6.2 lidhet me krijimin e një rrjeti kombëtar të vullnetarizmit. Gjatë vitit 2024, janë realizuar takime për rritjen e ndërgjegjësimit, hartimin e procedurave standarde; etj. Në pritje të ndryshimeve të Ligjit Nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, në të cilin është propozuar një ndryshim në tekstin ekzistues, lidhur me organizimin, funksionimin dhe trajtimin e vullnetarëve të Shërbimit Vullnetar të Mbrojtjes Civile, DETTI ka ndërmarrë hapat e mëtejshëm që rrjedhin nga ky ndryshim ligjor, sikurse dhe aktivitetet përkatëse.

✓ DETTI, për realizimin e objektivit është punuar edhe për ndryshimet ligjore të ligjit për vullnetarizmin. Gjatë vitit 2024, është zhvilluar programi i trajnimit bazë me disa module në bashkitë qendër qarku, me personel nga strukturat e mbrojtjes civile në nivel vendor, dhe nga drejtoritë rajonale të institucioneve qendrore, të cilat zhvillojnë aktivitetin e tyre në qendrat e qarqeve. Në një total prej 76 ditësh kalendarike, me 540 nëpunës të trajnuar.

Bazuar në planin e trajnimeve dhe stërvitjeve të mbrojtjes civile për vitin 2024, si dhe në zbatim të Marrëveshjes së Financimit me Nr. Prot., 2133/3, datë 10.01.2024, ndërmjet Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim dhe Ministrisë së Mbrojtjes e përfaqësuar nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, për fazën e parë, Mars-Prill-Maj 2024, nga DETTI u organizuan dhe u realizuan tre module trajnimi;

- Moduli 1: “Organizimi dhe funksionimi i sistemit të mbrojtjes civile”;
- Moduli 2: “Fatkeqësitë që prekin territorin e Republikës së Shqipërisë”;
- Moduli 3: “Planifikimi i menaxhimit të emergjencave civile”.

Trajnimet u zhvilluan në qendrat e prefekturave, në bashkitë qendër qarku, me personel nga strukturat e mbrojtjes civile në nivel vendor, si dhe personel nga drejtoritë rajonale të institucioneve qendrore, të cilat zhvillojnë aktivitetin e tyre në qendrat e qarqeve. Secili modul përmbante 12 orë trajnimi, në 2 ditë kalendarike, në 12 qarqe dhe me 2 trajnerë për çdo modul. Zhvillimi i ciklit të trajnimeve dhe moduleve të tjera ka vijuar dhe në periudhën e dytë Shtator-Dhjetor 2024.

Masa 6.6 - DZRFP raporton si më poshtë:

6.	Raportim dhe shkëmbim informacioni për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile jokohërent dhe i sakte (në të gjithë strukturat e sistemit të mbrojtjes civile, palët e interesit).	Përcaktimi i afateve, kriterëve dhe formatit. Monitorimi procedurave standarde.	DZRFP	Tetor 2025	Konsultime me palët e interesit; Krijimi një procesi standard.
----	---	--	-------	------------	--

✓Organizuar workshop-i (06.06.2024), mbi zhvillimin e kapaciteteve për ngritjen e një platforme të dedikuar: “Sistemit të Menaxhimit të Informacionit në fushën e Menaxhimit të Riskut të Fatkeqësive (MIS)”. Ky workshop erdhi si vijimësi e takimeve me stafin drejtues dhe teknik të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, me mbështetjen e projektit Reseal – UNDP, nëpërmjet ekspertit Ara Nazinyan. Qëllimi kryesor i këtij takimi ishte njohja e kësaj iniciative nga stafi dhe shkëmbimi i propozimeve për ngritjen e sistemit, i cili do të menaxhohet/koordinohet nga AKMC, si autoritet udhëheqës në procesin e implementimit. MIS sugjerohet si një mekanizëm funksional për të gjithë institucionet e përfshira në procesin e raportimit mbi aktivitetet dhe masat e marra në fokus të implementimit të dokumentave strategjikë (kryesisht monitorimin e implementimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit). Ky proces parashikon ndërtimin e një sistemi indikatorësh, një platformë online partner-donator, analizimin dhe konsultimin me struktura/institucione që raportojnë në AKMC apo anasjelltas etj. Status aktual i kësaj iniciative: Në proces.

Masa 6.7 - DETTI raporton si më poshtë:

7.	Nivel i ulët i njohurive dhe ndërgjegjësimi në nivel kombëtar për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile.	Rritja e ndërgjegjësimi për shoqërinë civile, grupet e marginalizuara dhe komunitetin.	DZRFP; DETTI; DGKPE.	2024-2026	Zhvillimi takimeve ndërgjegjësuse, workshope, aktivitete.
----	---	--	------------------------------------	-----------	---

✓ DETTI - Organizimi dhe ekzekutimi i stërvitjes “Command Post Exercise (CPX)” “Pishë Poro 2024”, në Fier, me skenar “Zjarr masiv në pyje”, me përfshirjen e 19 institucioneve dhe 65 nëpunësve.

Bazuar në planin e trajnimeve dhe stërvitjeve të mbrojtjes civile për vitin 2024, si dhe në zbatim të Marrëveshjes së Financimit me Nr. Prot., 2133/3, datë 10.01.2024, ndërmjet Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim dhe Ministrisë së Mbrojtjes e përfaqësuar nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, u konceptua dhe u vijua

me hapat parapërgatitëse të ekzekutimit të stërvitjes "Pishë Poro 2024", në Fier, në bashkëpunim me ekspertët e UNDP.

U ngritën grupet e punës, u përgatit skenari, u zhvilluan 2 konferenca planëzuese me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga 19 institucionet e përfshira në këtë stërvitje, u vendos qëllimi, objektivat dhe u ballafaquan mendimet dhe u ndanë eksperiencat personale të pjesëmarrësve në ngjarjen reale të zjarrit masiv në pyje në Pishë Poro gjatë vitit 2023. Po ashtu gjatë konferencës u bë dhe prezantimi i platformës "Disaster Aware", e cila do përdorej gjatë ekzekutimit të stërvitjes.

Ekzekutimi i stërvitjes u bë gjatë javës së parë të muajit Korrik 2024, për t'u vijuar më tej me krijimin e dokumentave dhe konferencës finale si dhe prezantimit të raportit përfundimtar në muajin Gusht 2024.

3. Konkluzione dhe Rekomandime

Ky raport monitorimi është kryer në përputhje me metodologjinë e monitorimit të instrumentit plan integriteti, dhe të hartimit të raportit të monitorimit.

Në përmbyllje të këtij raporti monitorimi për periudhën Janar-Dhjetor 2024, të gjetjeve që ky dokument na ofron, të të dhënave analitike që drejtoritë kanë raportuar dhe të analizës së kryer, rezulton se:

- Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile ka vijuar me zbatimin e planit të integritetit duke përmbushur të gjitha detyrimet e parashikuara në këtë dokument për vitin 2024;
- Drejtoritë e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, kanë shënuar përparime në fushën e transparencës dhe llogaridhënies, në rritjen e nivelit dhe cilësisë së punës së strukturave, nëpërmjet manualeve të proceseve të punës për çdo njësi të institucionit, dhe dokumenteve që rregullojnë në detaje proceset e punës të realizuara nga çdo strukturë/funksion i institucionit, në zhvillimin personal dhe profesional, forcimin e kapaciteteve të stafit si dhe në trajnimet dhe informimin e bashkive në lidhje me zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë;
- Është garantuar transparencë e plotë dhe ofrim i informacioneve mbi aktivitetin e agjencisë për publikun e gjerë nëpërmjet faqes së internetit www.akmc.gov.al;

4. Hapa të tjera

- Të vijohet puna për zbatimin e të gjithë masave të parashikuara në Planin e Integritetit të Institucionit nga njësitë raportuese të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, për vitin 2025 e në vijim;
- Të vijohet me vlerësimin dhe miratimin e planit të trajnimeve, për punonjësit e institucionit, për tre dokumentet e reja mbi etikën të miratuara nga DAP;
- Të vijohet me hartimin e dokumenteve përkatëse për përmirësimin e kuadrit për evidentimin e risqeve të korrupsionit në misione dhe operacione.